



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.05.2019, ora 11:00

Drejtojnë mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 06.05.2019.
2. Seancë dëgjimore me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me masat e marra për zbatimin e programit “Për vendosjen e oficerëve të sigurisë në shkollat e vendit, me qëllim parandalimin e fenomenit të dhunës, bulizmit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga hyrja në kanalet e lëndëve narkotike”.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Myslim Murrizi, Alban Zeneli, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Edmond Rrushu, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi, Xhavit Haliti dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Elona Hoxha dhe Ylli Shehu.

Të ftuar:

Romina Kuko – Zëvendësministre e Brendshme

Lorena Haxhiu – Zëvendësministre e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Merita Xhafaj – Drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Gerti Janaqi – Drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Alma Tandili – Drejtoreshë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Shkëlqim Allkaj – Përgjegjës Sektori pranë Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Fillojmë mbledhjen e Komisionit Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, ku, sipas rendit të ditës, do të kemi seancën dëgjimore me përfaqësues nga tri ministri: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme dhe nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Tematika e seancës së sotme dëgjimore lidhet me masat e marra për zbatimin e një programi, që, në fakt, besoj se është me interes për të gjithë “Për vendosjen e oficerëve të sigurisë në shkollat e vendit, me qëllim parandalimin e fenomenit të dhunës, bulizmit dhe mbrojtjes së fëmijëve nga krimet, që lidhen me lëndët narkotike”.

Të ftuar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare për të prezantuar masat e marra menjëherë pasi Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 600 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë” kemi: zonjat Lorena Haxhiu, zëvendësministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Romina Kukolli, zëvendësministre e Brendshme, Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Alma Tandili, drejtoreshë e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si dhe zotërinjtë Gerti Janaqi, drejtor i Institutit të Zhvillimit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dhe Shkëlqim Allkaj, përgjegjës Sektori pranë Burimeve Njerëzore po në këtë ministri.

U bëj me dije, gjithashtu, kolegëve se në tavolinë keni vendimin nr. 600 të Këshillit të Ministrave, të cilin do ta marrim sot nën monitorim, për të kuptuar se cilat janë masat e marra deri tani nga institucionet.

Në fakt, siç shihet nga përmbajtja e vendimit apo siç kuptohet edhe nga titulli i tij, kjo është një përgjegjësi e ndarë në disa institucione dhe që, të realizohet më së miri, natyrshëm do të duhet bashkëpunimi i të tria institucioneve, me qëllim që ideja për vendosjen ose për shpërndarjen e 150 oficerëve në shkollat e mesme (sepse për ato shkolla bëhet fjalë), sipas një liste të përcaktuar më parë, të mund të funksionojë realisht dhe oficerët e sigurisë nëpër shkolla të mos jenë vetëm ata që do të zbatojnë ligjin, por, njëkohësisht, ata që do të bëjnë ndërlidhjen ndërmjet shkollës, komunitetit të prindërve dhe më tej.

Është shumë e rëndësishme që fëmijët e kësaj moshe të mund t’i mbrojmë nga krimi ose nga pasojat e tij. Kështu që besoj se mënyra e zgjedhur nga qeveria është e duhura, por, sidoqoftë, na duhet të kuptojmë sesi kemi ecur: si ka filluar të zbatohet ky vendim? A i kemi

oficerët e sigurisë aktualisht të vendosur në shkollat e mesme të Shqipërisë? A janë trajnuar këta oficerë sigurie? Si presupozohet që të bashkëpunojnë oficerët e sigurisë, me qëllim që ngjarje, të cilat, herë pas here, media i bën publike, të mund të parandalohen?

Besoj se kjo seancë dëgjimore ka marrë shkas edhe nga ngjarja që ndodhi në Berat, ku një vajzë e mitur u detyrua që, për shkak të presioneve nga një bashkëmoshatar, t'i japë fund jetës. Ne nuk i dimë ende përgjegjësitë, se, sigurisht, ato përgjegjësi mbeten të zbardhen nga organi hetimor, por logjika të çon në atë që, nëse oficeri i sigurisë do të ishte vendosur në atë shkollë, nuk e di, natyrisht duhej të kishte luajtur një rol. Pra, presupozohet që oficerët e sigurisë të luajnë një rol në parandalimin e ngjarjeve të tilla dhe të mund të bëhen një pikë reference për të gjithë fëmijët e shkollave, në rast se kanë probleme të ngjashme.

Bulizmi nuk është një fenomen i panjohur ditët e sotme, përkundrazi, është i njohur, ndaj ndoshta do të duhet ta reflektojmë edhe në nivelin e Kodit Penal. Besoj se për këtë aspekt kolegët do të kenë pyetje dhe ne do të kemi rast të marrim opinionin tuaj. Sidoqoftë, kjo është tematika, e cila do të na interesonte të diskutonim gjatë ditës së sotme, çka besoj se mbetet me interes edhe për medien, por, njëkohësisht, për të gjithë prindërit dhe mësuesit e shkollave të mesme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ja, të mbaroj!

Fillimisht do t'ia jap fjalën zëvendësministres së Brendshme dhe pastaj zëvendësministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zoti Murrizi, për procedurë.

Myslim Murrizi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, në njoftimin që na është bërë si Komision Sigurie thuhej se do të vinin të raportonin tri ministri: ajo e Brendshme, ajo e Arsimit dhe ajo e Shëndetësisë. Nuk besoj se është serioze që në Komisionin Parlamentar për Sigurinë Kombëtare, në vend të ministrave, të vijjnë drejtorë dhe përgjegjës sektorësh.

Unë e di që po qeveriset me zëvendësministra, si, për shembull, një zëvendësministër i mandatuar si ministër i Punëve të Jashtme. Por, për të ruajtur autoritetin e institucionit të Kuvendit, edhe seriozitetin e Komisionit për Sigurinë Kombëtare, unë nuk besoj, mbështetur edhe në nenin 102 të Rregullores për funksionimin e Kuvendit dhe të komisioneve të përhershme parlamentare, që ka tagër çdo punonjës i ministrisë, sado i nderuar qoftë ai në konceptin tim, pra siç e shoh unë punonjësin e shtetit, për të ardhur në Komisionin për Sigurinë

Kombëtare dhe të raportojë para tij një përgjegjës sektori, siç është rasti sot, ku prezent kemi një përgjegjës sektori pranë Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Këta kanë hierarkinë e tyre brenda ministrisë së tyre për të raportuar tek eprorët përkatës, pra raportojnë te zëvendësministrat, dhe këta të fundit te ministri.

Sakaq, ministrat, që nuk janë paraqitur sot në këtë komision, ndoshta kanë pasur arsye të forta që nuk janë këtu. Nga ardhja e zëvendësministreve këtu nuk shoh ndonjë qamet të madh, por që të vijnë tre drejtorë, ku e di unë, një përgjegjës sektori, një pastrues dhe çfarë tjetër ka ministria, kjo është një tallje me institucionin e Kuvendit. Ndaj do të doja që t'i qëndronim lajmërimit të bërë zyrtarisht për të gjithë deputetët e Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

Kur kishte ndryshim axhende të këtij lloji dhe ministrat janë të ngarkuar, duhej të na vinit në dijeni. Unë nuk vij këtu si anëtar i Komisionit për Sigurinë Kombëtare për të dëgjuar një nga 155 mijë punonjësit që ka shteti.

Se kush raporton në komisionet e përhershme parlamentare, e keni të përcaktuar në Kushtetutë, por edhe në Rregullore është e përcaktuar qartë.

Në mungesë të tyre, nëse vijnë zëvendësministrat, nëse ai ministri është marrë vesh me ju, se është shumë i ngarkuar me punë, dakord, por pjesa tjetër nuk ka pse të vijë këtu; pjesa tjetër të raportojë atje ku merr rrogat.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Murrizi!

Do të më duhet t'i referohem sërish Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Përpara se të shkojmë te neni 102 i Rregullores, kemi nenin 36 të saj, i cili flet për seancat dëgjimore publike dhe, në fakt, sot kemi një seancë dëgjimore. Sipas nenit 36, komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarët e Këshillit të Ministrave, me përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara.

Kjo është seancë normale dëgjimore. Në rast se pastaj do të ketë kërkesë për një seancë dëgjimore, kërkesa duhet bërë me shkrim nga një e treta e numrit të anëtarëve. Po kështu, Rregullorja kujton që ministri, në çdo rast, është i detyruar të vijë kur e kërkon komisioni. Pra, në qoftë se komisioni bën kërkesë për ardhjen e ministrit, sigurisht që për mbledhjen do të përcaktohet ajo ditë kur vjen ministri.

Njoftimi që ne kemi bërë ka qenë që seanca dëgjimore të jetë me ministritë, jo me ministra; kështu është shprehur në kërkesën që ne u kemi dërguar.

Në qoftë se do të kishim kërkuar të vinte ministri, patjetër që nuk do të kishte asnjë arsye për të mos qenë ministri, por, nga ana tjetër, Rregullorja e ka të shprehur qartë se seancat dëgjimore në Kuvendin e Shqipërisë nuk realizohen ekskluzivisht me ministra, por edhe me përfaqësues të tjerë të lartë.

Besoj se institucionet na kanë respektuar, duke qenë se personi i dytë në radhë, që e zëvendëson ministrin, është zëvendësministri. Prezente kemi tri zëvendësministre, kjo jo për shkak se përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit ose asaj të Shëndetësisë e kanë të lidhur punën e tyre me këtë komision, sepse nuk e kanë të lidhur punën me këtë komision (janë raste të rralla kur këta përfaqësues mund të vijnë në komisionin tonë), por çështja që kemi në rendin e ditës e ndërlidh punën e tri institucioneve. Ndaj, natyrshëm, është e domosdoshme të jenë pjesë e kësaj seance dëgjimore, për të kuptuar ne se çfarë po bëhet, por, njëkohësisht, edhe për t'u nxjerrë në pah institucioneve konstatimet tona.

Kujtoj se ne kemi qenë në disa drejtori policie në nivel qarku dhe një pjesë e raportimit nga drejtuesit e tyre kishte të bënte edhe me punën që bëhet nga policia në shkolla për parandalimin e krimeve të ndryshme. Por ka munguar diçka në ato raportime, që lidhet pikërisht me çështjen që ne duam të trajtojmë sot. Ndaj, pa humbur kohë, do t'ua japim fjalën zëvendësministreve për të na shpjeguar çfarë masash kanë marrë në zbatim të këtij vendimi dhe se si është situata sot: i kemi efektivë oficerët e sigurisë, apo jo? A kanë një zyrë ata nëpër shkolla, apo jo? A bashkëpunojnë ata me psikologët, apo jo? A janë të njohur nga komuniteti i prindërve në shkolla, apo jo? A kanë drejtuesit e shkollave marrëdhënie me ta? Por edhe çështje të tjera si këto.

Mendoj se gjatë diskutimit do të marrim përgjigje për këto pyetje.

Zonja Kuko, fjala është për ju.

Romina Kuko – Faleminderit, zonja kryetare!

Përsëritet, të nderuar deputetë!

Në fakt, shumë mirë që ndodhen këtu të tria institucionet, sepse, siç e thatë edhe ju, kemi të bëjmë me një çështje që ndërlidh të tria institucionet, si një projekt multi-agjenci, që nuk kërkon vetëm punën e policisë, por edhe pjesën e parandalimit, e cila ofrohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, edhe pjesën e menaxhimit që ofrohet nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Zoti Janaqi dhe zonja Xhafaj kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në këtë projekt, kështu që e shoh me shumë vlerë prezencën e tyre në këtë komision.

Ajo çka unë do t'ju paraqes, është një rezymë përpara se projektvendimi ose vendimi i Këshillit të Ministrave të miratohej. Projekti në fjalë e pati gjenezën e tij në fillim të mandatit të dytë qeverisës, në tetor të vitit 2017, ku Ministria e Brendshme filloi të pilotonte konceptin e policimit në komunitet.

Si një projekt multiagjenci, i cili, siç e përmenda, nuk përfshin vetëm Ministrinë e Brendshme, por ka një komponent të domosdoshëm partneriteti me shkollat dhe me komunitetin, projekti “Shkolla të sigurta” ishte një domosdoshmëri, sidomos duke marrë shkas nga rastet e dhunës së përsëritur nëpër shkolla, ku, për fat të keq, kemi pasur edhe raste me fatalitet. Kështu që në atë kohë, me mbështetjen e OSBE-së, vlerësuam nevojat për të parë se si mund të ndërhyjmë, ndoshta brenda shkollave, për të parë dhe për të mbyllur zinxhirin e sigurisë.

Asokohe krijuam një platformë, pra një koncept-ide, që është kjo (mund t'jua vë në dispozicion), ku bëmë një analizë të përgjithshme të situatës së sigurisë nëpër shkolla dhe pamë praktikatat më të mira lidhur me eksperiencën e oficerëve të sigurisë në shkolla.

Duhet thënë që në vendet e Europës Perëndimore, por, gjithashtu, edhe në vendet, si Gjeorgjia, të cilat kanë bërë reforma të thella për sa i përket çështjes së sigurisë, roli i oficerit të sigurisë në shkolla është i pranishëm. Në disa vende oficeri është me uniformë, kurse në disa vende të tjera është thjesht një punonjës, i cili trajnohet për aspektet e sigurisë dhe është i pranishëm në shkollë.

Nga analiza e bërë, vumë re se rojat e shkollës nuk e plotësonin mjaftueshëm nevojën e shkollës për siguri, sepse ishin vetëm për pjesën e perimetrit të jashtëm. Ajo çka na duhej, ishte pjesa parandaluese, pra parandalimi i hershëm, ku ky oficer sigurie merrte shenjat e para të dhunës, të konflikteve dhe të çdo lloj problematike tjetër që kishte të bënte me sigurinë në shkolla. Kështu që, pas përfundimit të projekt-idesë dhe dakordësisë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ministri i Brendshëm nxori urdhrin nr. 167, datë 09.03.2018, ku mandatonte drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të nxjerrë aktet e nevojshme për transferimin e përkohshëm në detyrën e oficerit të sigurisë në shkolla të 15 oficerëve të Policisë së Shtetit.

Pse pilotuam me konceptin e oficerëve të Policisë së Shtetit? Sepse në atë kohë na duhej që ta pilotonim si koncept, por nuk kishim kohë të mjaftueshme për të bërë të gjithë procedurën e rekrutimit dhe trajnimit të stafit, plus donim të kishim një periudhë dy-tremujore për të parë se si do të funksiononte koncepti.

Këta oficerë policie u trajnuan në Akademinë e Sigurisë me kurrikula të përbashkëta, të hartuara nga Akademia e Sigurisë dhe Instituti i Zhvillimit të Arsimit, ku zoti Janaqi ka qenë

i përfshirë drejtpërdrejt. Pas dislokimit të tyre, pati një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të bashkëfirmosur nga të dy ministrat, e cila i hapte rrugën vendimit nr. 600, datë 09.10.2018 të Këshillit të Ministrave, i cili më pas e shtrinte konceptin e oficerit të sigurisë në shkolla jo vetëm në zonat pilot (ku ishin 15 shkolla të Tiranës), por në 150 gjimnaze të Shqipërisë.

Ajo çka mund të them, është që Ministria e Brendshme ka qenë e përfshirë në procesin e rekrutimit në komisione, në intervistimin e këtyre oficerëve të sigurisë në shkolla, në trajnimin e tyre dhe, gjithashtu, në hartimin e kurrikulave.

Para se t'ia kaloj fjalën koleges Haxhiu, dua t'ju them se nga prezenca e OSBE-së është bërë një raport-vlerësimi për 15 oficerët e parë të shkollave, të cilët kanë qenë të dislokuar. Vlerësimet janë maksimale dhe duket sikur i kanë dhënë frytet e tyre që në fazën e pilotimit, ku kemi mesatarisht 80 konflikte të shmangura në shkollat e Tiranës. Kjo ishte për pjesën përgatitore.

Po ia kaloj fjalën tani zonjës Haxhiu për detaje të mëtejshme.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Kuko!

Fjalën e ka zonja Haxhiu.

Lorena Haxhiu – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Mirëdita të gjithëve!

Ju falënderoj për mundësinë për të marrë pjesë në këtë seancë dëgjimore për një çështje shumë të rëndësishme, siç është siguria në shkolla!

Në vijim të asaj çfarë referoi zëvendësministria e Brendshme lidhur me projektin “Shkolla të sigurta”, i cili është një element thelbësor i parandalimit të dukurive negative si brenda, ashtu edhe jashtë mjediseve të shkollës, do të doja të referoja në terma më konkrete ecurinë e këtij projekti, prezantimin e figurës së oficerit të sigurisë në shkolla, si dhe impaktin që ai ka pasur gjatë kësaj periudhe, pra jo vetëm te komuniteti i nxënësve, por edhe te prindërit, si dhe bashkëpunimin real që ka pasur me strukturat: drejtorinë e shkollës dhe stafin mësimor.

Vitin e kaluar projekti është zbatuar në 15 gjimnaze të Tiranës, ku janë atashuar 15 oficerë sigurie, ndërsa këtë vit është shtrirë në 38 drejtori arsimore dhe zyra arsimore, në 150 shkolla, duke vendosur si kriter numrin e nxënësve, duke u nisur nga shkollat me numrin më të madh të nxënësve dhe duke vijuar në rendin zbritës. Aktualisht, janë plot 83 oficerë sigurie në detyrë, 46 të tjerë kanë përfunduar periudhën e trajnimit dhe në javët në vijim, pritet që t'u

atashohen shkollave përkatëse. Këta të rinj dhe të reja janë një vlerë e shtuar në një shkollë më të sigurt dhe më miqësore. Funkzioni i tyre lidhet ngushtësisht me parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të krimit dhe të dhunës në shkollë. Ata bashkëpunojnë ngushtësisht me drejtorinë e shkollës, me mësuesit, me psikologun dhe me anëtarët e tjerë të stafit për parandalimin dhe ndërhyrjen në rastet e thyerjes së disiplinës, dhunës brenda shkollës, ngacmimeve jashtë perimetrit të shkollës, përdorimit të mjeteve të forta, përdorimit të armëve të ftohta apo atyre të zjarrit, përdorimit të lëndëve narkotike, duhanit, alkoolit, menaxhimit të krizave, të rasteve të emergjencës etj.

Është shumë e rëndësishme të themi se oficerët e sigurisë nuk e zëvendësojnë rolin e mësuesve për përkujdesjen, mbikëqyrjen, sigurimin e disiplinës, rregullit dhe sigurisë në klasë. Ata janë të mirëpritur edhe nga mësuesit, edhe nga nxënësit, por nuk ndërmarrin masa disiplinore në shkollë, por raportojnë çdo shkelje të disiplinës pranë administratës së shkollës. Është bërë një njohje e tyre edhe me bordin e prindërve dhe të komunitetit.

Nga raporti është ndjerë një rritje e sigurisë në shkollë dhe një rritje e disiplinës. Vlen të theksohet se para dislokimit në shkollë të gjithë oficerët e sigurisë u nënshtrohen testimit dhe certifikimit me një seri modulesh multidisiplinare, që po i citoj shkurtimisht: menaxhimi i situatës në raste dhune në shkollë, dhënia e ndihmës së shpejtë në rast nevojë, teknika të zgjidhjes së problemeve, legjislacioni bazë, çështje gjinore, psikologjia e të miturve, njohja e shenjave të deviancës së adoleshentëve etj.

Nëse i referohem ecurisë së projektit pilot të zbatuar gjatë vitit të shkuar shkollor, janë parandaluar 80 raste në plot 10 javë në 15 shkollë të mesme. Një pjesë e mirë e tematikave lidheshin me: konfliktet verbale dhe fizike nxënës-nxënës; konfliktet verbale nxënës-mësues; hyrjet e paautorizuara në territorin e shkollës, të cilat ndodhin rëndom dhe prishin rendin dhe qetësinë, gjithashtu cenojnë edhe procesin arsimor, për konsumin e duhanit, apo të lëndëve narkotike në ambientet e shkollës apo në perimetrin e saj; abuzime me hapjen e një profili të rremë në rrjetet sociale në emër të një nxënësi apo të një nxënëseje, vjedhja e telefonave celularë, tërheqja e vëmendjes nxënësve, që vijnë me vonesë në orën e parë, tërheqje e vëmendjes nxënësve, që largohen nga orët e mësimi.

Në vijë të përgjithshme, ky është prezantimi i raportit për pilotimin e projektit të vitit të shkuar, ku janë përfshirë 15 shkollë të mesme në Tiranë. Ndërkohë, projekti po vijon të implementohet edhe gjatë këtij viti shkollor.

Nëse më lejoni, sigurisht brenda kohës në dispozicion, doja të radhisja edhe një sërë masash në kuadër të sigurisë në shkollë që Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në

bashkëpunim me institucionet qendrore, por edhe me partnerët ndërkombëtarë kanë ndërmarrë, duke i parë të materializuara si nisma, si projekte dhe programe.

Me lejen tuaj, zonja kryetare, ju bëj me dije se për të tretin vit radhas kemi ndërmarrë nismën “Stop dhunës në shkollë”. Në të gjitha shkollat janë ngritur tashmë dhe funksionojnë komisionet e etikës, që ndër të tjera, trajtojnë edhe rastet e sjelljes së dhunshme në institucionet arsimore.

Takimet me punonjësit e Policisë së Shtetit në shkolla u kanë shërbyer ndërgjegjësimit të nxënësve, por edhe të prindërve për denoncimin e rasteve të dhunës por dhe për t’i parandaluar ato.

Shërbimi komunitar në shkolla në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Shqiptar nuk ka nxitur vetëm vullnetarizmin dhe humanizmin, por shpesh ka qenë edhe të mësuarit për të dhënë ndihmën e parë në raste të ndryshme të dëmtimeve apo të dhunës. Një projekt shumë i rëndësishëm në kuadër të krijimit të politikave të qëndrueshme në shkolla kundër bulizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është edhe ai me mbështetjen e KE-së, që është implementuar tashmë në 21 shkolla “Lufta kundër bulizmit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor parauniversitar”.

Së fundi, janë organizuar ditët e hapura me qëllim ndërgjegjësimin, informimin mbi bulizmin dhe ekstremizmin, pasojat dhe parandalimin e tyre me pjesëmarrjen e qeverisë së nxënësve bordit të prindërve, mësuesve, prindërve, anëtarëve të komunitetit, si dhe medias.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Haxhiu!

Në fakt, para se t’ua kaloj fjalën kolegëve për pyetje, do të doja që ju të na bënit një listim të shkollave se ku janë shpërndarë aktualisht oficerët e sigurisë, që ju thatë se janë efektivisht në punë. Në cilat shkolla të mesme janë? Kini parasysh se çdo komision parlamentar ka përfaqësi deputetësh nga qarqe të ndryshme të Shqipërisë. Besoj se kjo do ta bënte edhe më interaktiv diskutimin tonë për këtë çështje. Pra, ne e kemi informacionin për shkollat e Tiranës. Na bëni një listim, se ku dhe si janë shpërndarë!

Zoti Janaqi, meqë ju jeni marrë drejtpërdrejt me zbatimin e projektit, besoj se mund të na thoni diçka më të detajuar.

Gerti Janaqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Para se të listoj drejtoritë dhe zyrat arsimore, apo shkollat në të cilat janë punësuar oficerët e sigurisë, doja të bëja vetëm një sqarim të vogël teknik: kur flasim për oficerë sigurie,

nuk flasim për oficerë policie. Koncepti i pilotimit ka qenë me oficerë policie, por ata tani janë të rinj dhe të reja, të cilët kanë studiuar kryesisht në fushën e drejtësisë, në shkencat sociale apo në mësuesi. Ky ka qenë edhe mendimi që ka ardhur edhe nga Ministria e Brendshme, pasi ne gjykonim që figura e policit në vetvete ishte një figurë e rëndë, e cila nuk krijonte procesin e bashkëbisedimit të lirshëm të oficerit të sigurisë dhe u gjykua që këta do të duhej të ishin të rinj apo të reja të arsimuar, të trajnuar nga Akademia e Sigurisë.

Para se të vijojmë me një analizë për mënyrën se si janë rekrutuar këta persona, më lejon të ndaj me ju informacionin që oficeri i sigurisë, ashtu siç e theksuan edhe dy zëvendësministrat, nuk zëvendëson as figurën e drejtorit të shkollës, as figurën e psikologut, as figurën e çdo njësie të shërbimeve mbështetëse, por është një person (mashkull apo femër), i cili duhet të koordinojë të gjithë informacionin. Ne i kemi informuar edhe prindërit, edhe mësuesit, për funksionin që ata kanë. Lista fillon (po i kaloj shumë shpejt, por besoj se ju duhet t'i keni në anekse). 150 punonjësve të sigurisë, që është parashikuar të ndahet sipas numrit të nxënësve, fillon me këtë numër oficerësh sigurie: 17 për qytetin e Tiranës, 13 për Elbasanin, 12 për Durrësin, për Tiranën qark 11, për Shkodrën 7, për Fierin 6, për Kamzën 6, për Korçën 7, për Beratin 5, Lushnjën 5, Kavajën 4, Krujën 3, Kurbinin 4, Lezhën 4, Librazhdin 4, Pogradecin 4, Vlorën 4, Dibrën 3, Matin 3, Bulqizën 2, Gjirokastrën 2, Kuçovën 2, Kukësin 2, Malësinë e Madhe 2, Mallakastrën 2, Peqinin 2, Pukën 2, Skraparin 2, Delvinën 1, Devollin 1, Gramshin 1, Hasin, 1. Kolonja, Përmeti, Mirdita, Saranda, Tepelena dhe Tropoja kanë nga një oficer sigurie.

Parimi i ndarjes së numrit të këtyre punonjësve nuk ka të bëjë me madhësinë e territorit apo me shtrirjen gjeografike të shkollave në territor, por ka të bëjë me dendësinë e numrit të nxënësve. Kjo do të thotë që nëse Elbasani ka 13 oficerë sigurie dhe Tepelena ka 1, numri i shkollave apo dendësia e nxënësve në shkollat e Elbasanit është shumë herë më i lartë sesa në shkollat Tepelenës.

Aktualisht, siç u përmend edhe më sipër, komisioni i rekrutimit, i cili është përbërë nga 2 përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, 2 përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe një përfaqësues nga Urdhri i Psikologut deri tani ka rekrutuar 80 oficerë sigurie dhe deri në fund të majit janë në fazën e fundit të punësimit edhe 46 punonjës të tjerë në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Sigurisht, është edhe një listë akoma më e detajuar me emrat e shkollave, ku punojnë këta, por për efekt kohe nuk po e kalojmë, gjë që do të thotë që deri në fund të majit numri shkon në 126 dhe, duke zhvilluar fazën e fundit në periudhën e korrikut, shtatori i gjen të

plotësuar të 150 vendet. Mund të duket si detaj teknik, por duhet thënë për ta saktësuar, se këta oficerë sigurie kanë 4 elemente raportimi: një memo javore, një raportim ditor dhe një raportim mujor. Këto janë 2 fisha elektronike që shkojnë drejtpërdrejt brenda DAR-eve apo zyrave arsimore dhe, njëkohësisht u shkojnë edhe strukturave të rendit, në mënyrë që i gjithë raportimi të identifikohet kollaj nga të dyja strukturat dhe do të përpunohet në baza mujore.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Janaqi për ndërhyrjen tuaj dhe për sqarimet e mëtejshme që dhatë!

Unë mendoj se është më mirë ta hapim diskutimin dhe të gjithë kolegëve t’u japim mundësi të drejtojnë pyetjet e tyre.

Urdhëroni, zoti Qefalia!

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, të gjithë panelit për ekspozenë! Veçanërisht, falënderoj zotin Gerti për konstatimet e sakta dhe konkrete!

Unë do të isha i interesuar për të gjithë aktivitetin dhe punën që kanë bërë këta oficerë sigurie. A kanë pasur takime me bordin e prindërve dhe me drejtuesit e shkollave dhe këta përfaqësues për t’u njohur me problematikën? Dikush nga ju përmendi një shifër për disa ngjarje që janë paraprirë. Këto kanë ardhur si rezultat i vendosjes dhe i punës së këtyre punonjësve të sigurisë?

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Qefalia!

Nuk e di se cili nga përfaqësuesit e ministrive do ta jepte përgjigjen.

Urdhëroni, zoti Janaqi!

Gerti Janaqi – Sigurisht, ne jemi përpjekur të forcojmë marrëdhënien e oficerëve të sigurisë jo vetëm me bordet e prindërve, por edhe me këshillat profesionale të mësuesve (po mundohemi të ruajmë të njëjtën emërtesë edhe për lehtësi komunikimi), edhe me vetë nxënësit. Them se në shkollat, ku problematikat kanë qenë më të mëdha dhe këto janë kryesisht zonat urbane, ku dendësia e nxënësve është shumë e madhe, oficerët e sigurisë si meshkuj, si femra, janë mirëpritur. Është shumë e nevojshme të sqarohet roli i tyre. Ne kemi bërë trajnime intensive dhe jemi nisur edhe nga një parim tjetër për të mos vendosur ekuivalencë mes qytetit apo fshatit, apo një shkolle të caktuar etj.

Rastet janë aq të ndryshme dhe aq specifike, sa vërehen nga njëra zonë në tjetrën. 80 raste në javë parandalohen nga konfliktet e vogla deri te ngjarjet më të rënda, të cilat nuk janë pak. Sigurisht, ka ende shumë punë për të bërë. Të gjithë këta njerëz janë nën trajnim të vazhdueshëm. Desha të ndaj me ju faktin që masa e trajnimit vjen duke u shtuar. Këta po

trajnohen edhe për çështjet e radikalizmit të dhunshëm. Ju e dini që kemi një program kombëtar për çështjet e parandalimit të radikalizmit të dhunshëm. Gjithashtu, jemi pjesë e një marrëveshjeje me qeverinë britanike (jo vetëm Shqipëria, por të gjitha vendet e Europës Juglindore), për të zbatuar një program të ri në muajin shtator, në të cilin do të jenë pjesë edhe oficerët e sigurisë për çështjet e parandalimit të përfshirjes në krimin e organizuar.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Zeneli!

Alban Zeneli - Faleminderit, zonja kryetare!

Meqenëse ne si komision e pranuar që të vinin të raportonin te ne, edhe drejtues të tjerë dhe jo vetë ministri, kisha një pyetje specifike për Gertin, për zotin Janaqi, meqë është më i involvuar në këtë proces. Në raportin që keni dërguar te ne, ju keni përcaktuar që oficerët e sigurisë janë vetëm për shkollat e mesme, por problemet më të mëdha, jo vetëm ne si komision, por edhe opinioni publik, i shohim edhe te shkollat 9-vjeçare, kur dihet që ajo moshë është edhe më delikate sesa pjesa e shkollës së mesme.

Cila është arsyeja që ju nuk e keni parashikuar që oficerët e sigurisë me të vërtetë shumë të rëndësishëm në atë proces për ruajtjen e sigurisë të nxënësve nëpër shkolla, nuk janë parashikuar të jenë edhe në shkollat 9-vjeçare?

Ermonela Felaj – Besoj se pyetja e zotit Zeneli është e qartë. Fjala për zotin Janaqi, meqë është aplikues për herë të parë i këtij projekti!

Gerti Janaqi – Bashkohem me konstatimin tuaj. Ky ka qenë një diskutim i kahershëm mes dy ministrive, por nga të dhënat tona, pavarësisht problematikave që ka në shkollat 9-vjeçare, na rezultonte që risku më i lartë për përfshirje jo vetëm në format e keqtrajtimit, të dhunës, etj., por edhe sjellja me rrezikshmëri më të lartë, vinte kryesisht nga mosha 14 vjeç e sipër.

Ne do të donim të kishim një numër më të lartë punonjësish sigurie dhe të përfshinin edhe shkollat 9-vjeçare. E kemi gjykuar edhe në fazën e pilotimit që gjimnazet janë ato që kanë riskun më të lartë. Kjo ishte arsyeja pse vijoi edhe në VKM-në që erdhi nga qeveria përcaktimi i numrit të **OS-ve** krahas gjimnazeve. Ndoshta nga Ministria e Brendshme mund të kemi argumente më të detajuara.

Ermonela Felaj – Po, zonja Kuko.

Romina Kuko – E vlerësoj me vend komentin e zotit Zeneli.

Ne kemi bërë një analizë risku dhe pamë që prevalenca më e madhe për të ushtruar dhunë ishte në gjimnaze. Ndërkaq, shkollat 9-vjeçare i kemi mbuluar me një program të

Policisë së Shtetit, i cili mbështetet nga misioni amerikan ICITAP me trajnime të vazhdueshme, të cilat fillojnë që në klasën e gjashtë deri në klasën e nëntë, ku trajtohen problematikat e konsumit të lëndëve narkotike, bullizmi, ekstremizmi i dhunshëm, e të tjera. Pra, ne kemi oficerë policie të pranishëm në trajnimet në shkollat 9-vjeçare.

Argumenti i dytë është që ne donim ta pilotonim këtë në gjimnaze, për të parë boshllëqet që mund të dalin gjatë rrugës. Kështu që, para se ta instalonim në shkollat 9-vjeçare, ku problemi është edhe më delikat, sepse janë më të vegjël në moshë, donim të shikonim se si funksionon. Objektivi është që këta 150 oficerë sigurie t'i kemi të shpërndarë edhe në gjimnaze të tjera të Shqipërisë (janë mbi 300 gjimnaze në mos gabo), por problemi është që ne duhet ta kolaudojmë shumë mirë projektin.

Për sa i përket çështjes së mbikëqyrjes së shkollave, Policia e Shtetit ka riformatuar strukturën e saj në nivel vendor dhe ne tani kemi edhe pozicionin e oficerit të policisë për mbrojtjen e të miturve dhe dhunës në familje, i cili është përgjegjës për monitorimin e shkollave. Kështu që, jo se shkollat 9-vjeçare nuk i kemi të mbuluara, thjesht ende nuk kemi një oficer të dedikuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Kuko!

Fjalën e ka zonja Dhima dhe më pas zoti Maliqi.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zonja kryetare për organizimin e kësaj seance dëgjimore shumë të rëndësishme për sigurinë në shkolla! Në fakt, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 9.10.2018 ka si qëllim monitorimin e institucioneve të arsimit parauniversitar duke pasur një ndërveprim të vazhdueshëm midis nxënësve, personelit mësor dhe komunitetit.

Unë kam dy pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit.

Së pari, si e vlerësoni ju bashkëpunimin midis psikologut të shkollës, oficerit të sigurisë, drejtuesit të shkollës dhe komunitetit?

Së dyti, në marrëveshjen që është lidhur midis Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në nenin nr.7 thuhet që oficerët e sigurisë duhet të kenë mjedisin e tyre të punës brenda shkollës të pajisur me mjetet e domosdoshme, ku të zhvillojnë takime me prindërit dhe oficerët e Policisë së Shtetit që janë përgjegjës për policimin në komunitet. A e keni plotësuar ju këtë detyrim sipas marrëveshjes dypalëshe dhe sa është numri i shkollave ku ju i keni plotësuar? Nëse i keni plotësuar 100 përqind, bravo ju qoftë!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Po, zoti Janaqi.

Gerti Janaqi – Ne jemi bazuar në disa vlerësime. Jemi munduar të bëjmë vlerësime të brendshme dhe të jashtme. Ashtu siç e përmendi edhe zëvendësministria e Brendshme, është bërë një vlerësim i jashtëm nën asistencën e OSBE-së në muajin nëntor. Ndërkohë, vlerësimet tona tregojnë që situata e bashkëveprimit midis aktorëve (shërbimi psikosocial, prindër apo mësues), është funksionale. Rolit i oficerit të sigurisë është mirëpritur. Unë e përmenda pak më përpara që ai nuk replikon. Ne po tentojmë t'i shtyjmë oficerët e sigurisë që të fitojnë zemrat e nxënësve, nëse mund ta thjeshtojmë akoma më shumë diskutimin. Koncepti i një oficeri sigurie është koncepti i personit, i cili duhet të fitojë besueshmërinë e një nxënësi në mënyrë që një nxënës ta ketë më të lehtë të referojë një rast ose të ndaj një shqetësim. Ky është qëllimi final i projektit. Më shpejt tek një njeri që e ka brenda shkollës sesa të shkojë në rajonin apo pikën më të afërt. Më pas është oficeri i sigurisë që njofton strukturat përkatëse. Më shumë është çështje besueshmërie që ne po e forcojmë këtë pikë, në mënyrë që të ketë një bashkëpunim më të mirë.

Për sa i përket akomodimit, ka një urdhër specifik dhe porosi të veçantë që oficerët e sigurisë në çdo shkollë të akomodohen në ambiente të veçanta.

Sigurisht, atje ku ka pasur infrastrukturë më moderne apo shkolla me hapësirë më të madhe, oficerët e sigurisë janë instaluar në zyrë më vete, kurse në shkollat ku kjo ka qenë e pamundur ata ndajnë ambientin me psikologët e shkollave. Shpërndarja nuk është realizuar 100 përqind. Ne presim që në fund të muajit maj numri të shkojë 86, në mënyrë që që vitin e ri shkollor të 150 oficerët të jenë të dislokuar në shkolla.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Maliqi dhe më pas zoti Murrizi.

Lifter Maliqi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, nga sa u raportua nga të ftuarit, kjo është gjë e mirë, sepse vendosja e oficerëve të sigurisë ka të bëjë shumë me efektin psikologjik.

Pyetja ime është për të dy zëvendësministrat.

Sa zgjat periudha e trajnimit të oficerëve përpara se ata të merren në detyrë dhe çfarë shenjash dalluese kanë? Shkollat e mesme ku ju keni vendosur oficerë sigurisë janë në zona që mbulohen nga inspektorë rendi dhe agjentë krimesh. Cili është bashkëpunimi i oficerëve të sigurisë me inspektorët e zonës, në bazë të marrëveshjes që është bërë midis Ministrisë së Arsimit dhe asaj të rendit?

Së fundi, a janë bërë takime në shkollat e mesme me përfaqësues të drejtorive të policisë, të zyrës së antidrogës, të rendit dhe të sigurisë?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Maliqi!

Në fakt, meqenëse një nga pyetjet e mia lidhet me pyetjet e zotit Maliqi, ju lutem na shpjegoni kriteret që duhet të plotësonin njerëzit e interesuar për të bërë këtë detyrë? Si është bërë përzgjedhja e tyre? Sa kohë kanë ndenjur në Akademinë e Rendit? Kur kanë filluar punë, si është bërë prezantimi i tyre dhe nga mbikëqyret puna e tyre? Ju thatë që ata dërgojnë raporte periodike në periudha të shkurtra. Sidoqoftë, unë besoj se duhet të ketë një person përgjegjës që e kontrollon punën e tyre. Është në ministri apo është shpërndarë edhe më poshtë?

Romina Kuko – Për sa i përket pyetjes së zotit Maliqi për ndërlidhjen e oficerëve të sigurisë me policinë, duhet thënë që koncepti i oficerit të sigurisë në shkolla ishte që ne të kemi një pikë lidhëse të shkollës me Policinë e Shtetit. Për shembull, kur ndodhte një konflikt në shkollë, nuk ishte e qartë kush telefononte nr. 129 apo nr. 112, në rastin konkret. Për sa i përket parandalimit të dhunës, arrinim shumë vonë ose në momentin që ajo kishte filluar.

Kështu që, koncepti i oficerit të sigurisë në shkolla është që ky individ të trajnohet për shenjat e para të konfliktit, për shenjat e para të radikalizmit, jo vetëm brenda territorit të shkollës, por ky person do të ishte dhe është përgjegjës edhe për risqet dhe rreziqet që i kanosen institucionit arsimor jashtë territorit të saj, siç është rasti i shitjes së lëndëve narkotike në perimetrin e shkollës, që është provuar e frytshme, sepse kemi pasur edhe raste të goditjes së këtyre personave jashtë perimetrit të shkollës.

Në trajnimin që ata kanë bërë, kanë marrë shenjat e paralajmërimit të hershëm, pra, si të evidentojnë individë me tendenca agresive apo informacion që ata e marrin nga psikologu i shkollës. Gjej rastin të them që në takimin final që ne patëm pas fazës së pilotimit me drejtorët e shkollave, me psikologët e shkollave dhe oficerët e sigurisë, u duk se kemi krijuar një trekëndësh shumë eficient, sepse psikologu është ai që merr informacionin paraprak dhe oficeri i sigurisë në shkollë më pas e referon.

Për sa i përket pranisë së oficerëve të policisë, ne e dimë shumë mirë që kemi specialistët e policisë së zonës, SPZ-të, të cilët mbulojnë territorin. Sidomos në zonat ku ka institucione arsimore ka takime të përjavshme midis oficerëve të sigurisë së shkollës dhe SPZ-ve. Ka një direktivë për këtë pjesë.

Gjithashtu, siç jua thashë edhe më përpara, pas ristrukturimit të drejtorive vendore të policisë, kemi edhe punonjës të dedikuar. Kjo do të thotë që komunikimi midis tyre është i shpeshtë. Ata raportojnë te drejtoria arsimore për sa u përket procedurave të tyre standarde të raportimit. Ka një format të posaçëm për këtë, të cilin e kemi hartuar së bashku me ministrinë

e arsimit. Gjithashtu, kemi edhe një format për sa i përket vlerësimit të riskut, të cilin e marrim edhe ne si Ministri e Brendshme nga drejtoritë vendore të policisë.

Tani po ia kaloj fjalën koleges.

Lorena Haxhiu – Në përputhje me profilin që secili prej oficerëve të sigurisë, që do të shërbejë në shkollat e mesme të vendit do të ketë, janë vendosur edhe kriteret e veçanta, pasi kriteret e përgjithshme janë ato që përdoren nga Departamenti i Administratës Publike në periudhën e rekrutimit të secilit prej punonjësve.

Për faktin që thamë se oficerët e sigurisë nuk do të zëvendësojnë mësuesin, drejtorin e shkollës, oficerin e policisë dhe as psikologun apo punonjës social, por do të jetë një figurë e ndërmjetme, që do të marrë masa për parandalimin e dukurive negative në shkollë, duke bashkëvepruar shumë mirë me nxënësit, stafin pedagogjik por edhe me prindërit, më lejoni të citoj kriteret e veçanta, që janë transparente edhe në shpalljen që ka bërë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë:

1. Duhet të ketë diplomë të ciklit të dytë ose të barasvlershme me të në fushën e edukimit, në disiplinat e shkencave sociale, sociologjisë, psikologjisë ose drejtësisë.
2. Të jetë jo më shumë se 40 vjeç.
3. Të ketë njohuri të mira kompjuterike.

Kam përshtypjen se mund të ketë pyetje për pikën e dytë. Ky kriter është i rëndësishëm për faktin se thamë që profili duhet të jetë sa më afër adoleshentëve, të cilët janë nxënës të shkollave të mesme. Pra, ajo nuk do të jetë një figurë e largët me uniformë, por një figurë që do të konfidoj te nxënësit e shkollave të mesme.

Për sa i takon dokumentacionit, mënyrës dhe afatit të dorëzimit, sigurisht që plotësohet një dosje e mirëfilltë. Pas kësaj, të gjithë aplikantët që kanë përmbushur kriteret dhe kanë dorëzuar dokumentacionin përkatës do t'i nënshtrohen një testi me 100 pikë tek Akademia e Sigurisë. Më pas do të realizohet një intervistë me 30 pikë pranë një komisioni të posaçëm që është ngritur me përfaqësues nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe nga Ministria e Brendshme. Në fund, të gjithë aplikantët e kualifikuar i nënshtrohen një trajnimit 1 mujor.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Po, zoti Murrizi.

Myslym Murrizi - Kam dy pyetje dhe një parashtrim, sepse e shikoj që relatorët flasin sikur kjo punë ka vite që po bëhet.

Në fakt, vendimi i qeverisë është i tetorit të vitit 2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do edhe gjashtë muaj të mbushë vitin.

Vendimi i qeverisë është i tetorit të vitit 2018. Në nëntor ka hyrë në fuqi, në dhjetor ka qenë Viti i Ri. Pra, kemi rreth 5 muaj që po bëhet ky aplikim. Në shpjegimet që dha zëvendësministria e Brendshme u tha se deri tani janë të punësuar gjithsej 46 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thatë që 80 janë të rekrutuar, kurse 46 janë në punë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa zgjat trajnimi tek Akademia e Sigurisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një muaj.

Në 150 shkolla keni planifikuar oficerë. Cili ka qenë kriteri i përzgjedhjes së shkollave, sepse gjithsej janë rreth 300 gjimnaze dhe është zgjedhur gjysma e tyre?

Në listën që kam përpara unë shikoj që janë zgjedhur gjimnaze me nga 150 nxënës, siç ishin rastet e fundit: Kamza, Çorovoda, Skrapari, Tepelena. Cili ka qenë kriteri i përzgjedhjes së gjimnazeve? Gjysma do të monitorohen nga oficerë sigurie dhe gjysma e tyre nuk do të monitorohen. Dua të di se çfarë kriteresh ka pasur parasysh treshja e ministrave, i Brendshmi, i Arsimit dhe i Shëndetësisë?

Fjala “oficer”, për të gjithë ata që e dëgjojnë në përditshmëri, duke pasur parasysh edhe kriteret, siç thatë edhe ju për profesionet që janë të rekrutuar dhe do të shërbejnë në këto gjimnaze, është e kundërta e termit popullor “oficer”. Më parë ideja për termin “oficer” ka qenë për të gjithë ata që ishin oficerë të Akademisë së Policisë. Fakti që ju thoni se ata duhet të jenë nga shkencat sociale apo nga psikologjia, mendoj se nuk do të ishte keq të gjenin diçka më të zbutur se fjala oficer, pasi me aq sa unë po shoh në rolin bazë të tyre ata më shumë janë si bilbilfryrësat, për të cilët ka dalë një vendim me VKM dhe filtrohen në administratë, pra në një farë mënyre raportojnë.

Kur e dëgjojnë fjalën “oficer”, qytetarët mendojnë se fëmijët e tyre janë të sigurt, pasi çdo shkollë ka nga një oficer dhe fëmijët nuk i ngacmon njeri. Ndërsa këta që thoni ju në një farë mënyre qenkan si punë psikologu, pjesë e stafit pedagogjik, pra një më shumë, i cili merret me një punë hetimore apo kërkimore se çfarë bëhet në shkollë dhe më pas raporton në drejtori ose i bie 129-ës, pak a shumë është si punë centrali. Pra, në mënyrë që të mos i bien këtij numri vetë fëmijët, sepse ata ndonjëherë tallen, është gjetur dikush që të paguhet. Gjëja

që më bëri më shumë përshtypje ishte mosha, sepse personi që duhej të bënte këtë punë duhej të ishte nën moshën 40 vjeçare. Çfarë keni pasur parasysh kur keni vendosur këtë kriter?

Ka persona që lindin 12 vjeç nga logjika dhe po aq vdesin, pra nuk e përcakton pasaporta se çfarë ke në mendje. Një person mund të jetë 80 vjeç dhe nga mendja e kokës është adoleshent, prandaj doja të dija se çfarë testesh bëni ju për t'i marrë këta persona në punë? Unë mendoj se koha për t'i përzgjedhur këta persona duhet të jetë më shumë sesa 1 muaj, si dhe anëtarët e komisionit duhet të jenë njerëz të përzgjedhur në mënyrë që edhe ata që do të zgjidhen të jenë persona të aftë për ta kryer atë punë.

Keni parë shumë njerëz që janë në moshë të thyer nga 80 apo 90 vjeç, të cilëve u ka ikur mendja e kokës dhe janë në burg për shkak të veprimeve që kanë kryer, si, ngacmime të fëmijëve, të adoleshtëve apo të minorenëve. Dua të di se si mund të zgjidhet ky problem, pasi mosha nuk ka aq shumë rëndësi, sidomos ky brezi i ri do të jetë me adoleshencë të stërzgatur deri në moshën 60-70 vjeçare.

Sa është raporti i të punësuarve? Me këtë numër që ju keni vënë 126, besoj se do të mbyllet deri në fund të muajit apo jo? Sa nga këta janë femra dhe sa prej tyre meshkuj? Cili kriter është marrë parasysh për t'i punësuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Elementi më i ndjeshëm nëpër gjimnaze është ai i femrave, prandaj do të ishte mirë që te këta kujdestarë, që ju i keni titulluar “oficer sigurie”, mendoj se do të ishte më mirë që numri i femrave të punësuar të ishte më i madh. Dua të di nga këta 126 të punësuar sa janë femra dhe sa meshkuj?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Kush do të përgjigjet nga ju?

Po, zonja Kuko.

Romina Kuko – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Murrizi!

Pjesa më e madhe e atyre që ju sapo thatë ishin vërejtje me vend. Sa i takon pjesës së kritereve dhe detyrave që ata kanë, po përfitoj nga rasti t'ju listoj disa nga detyrat dhe përgjegjësitë kryesore që kanë oficerët e sigurisë nëpër shkolla. Në parantezë ne i quajtmë “oficerë”, pasi e kemi menduar shumë gjatë këtë pjesën e etiketimit, sepse donim që të kishte një komponent të forcimit të ligjit dhe për këtë arsye i quajtmë “oficerë sigurie”. Ata janë persona pa uniformë, nuk kanë mjete policore, kanë një shenjë dalluese, por i kemi quajtur “oficerë sigurie”, nisur edhe nga takimet që kemi bërë me prindërit dhe kjo nuk është parë si

problem nga ana e tyre, përkundrazi është mirëpritur si term, sepse roli i tyre ka qenë shumë i moderuar sa u takon detyrave.

Po ju listoj disa nga detyrat që do të kenë këta oficerë sigurie:

Siç jua thashë, këta oficerë sigurie janë shumë të rëndësishëm për monitorimin e mjedisit nëpër shkolla, si dhe për risqet e mundshme që mund të ketë ai mjedis shkolle brenda dhe jashtë perimetrit të saj.

(Diskutime pa mikrofon)

Le t'i quajmë edheurve, nuk ka asnjë gjë të keqe të survejosh, sepse në këtë mënyrë monitorohet mjedisi i shkollës vazhdimisht, si dhe situatat e dyshimta, siç mund të jetë hyrja e personave të paautorizuar apo cenimi i pronës së shkollës.

- Parandalon dhe menaxhon rastet emergjente të dhunës në shkollë.
- Kontribuon në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, ligjin dhe drejtësinë.

Dua t'ju them që së bashku me Institutin e Zhvillimit të Arsimit këta oficerë sigurie, në një hap të mëpasshëm, sepse do të kenë trajnime të vazhdueshme, do të jenë vetë ata që do t'i trajtojnë nxënësit për komponentët e sigurisë, qoftë për mbrojtjen nga zjarri, duke bërë ushtrimet e nevojshme brenda shkollës, qoftë për parandalimin e narkotikëve. Pra, në këtë mënyrë ata marrin një rol ekstra, jo vetëm survejues, por edhe edukues në shkollë.

Bashkëpunojnë me drejtorinë e shkollës dhe stafin pedagogjik për të garantuar dhe krijuar një mjedis të sigurt.

Krijojnë një plan sigurie të shkollës, duke përcaktuar risqet e mundshme, daljet emergjente dhe duke minimizuar burimet e aksidenteve.

Unë besoj se nuk ka prind që nuk do të donte të kishte një person, i cili shikon edhe këtë element të mbarëvajtjes.

Evidentojnë situatat e parregullta të rendit dhe të sigurisë publike brenda dhe jashtë perimetrit të shkollës dhe njoftojnë oficerin e policisë së komunitetit.

Shërbejnë si oficerë raportues, menaxhues të situatave.

Bashkëpunojnë dhe ndërmjetësojnë me punonjësit e shërbimit psiko-social.

Duhet thënë se në qoftë se në pilotimin që ne patëm ku 15 personat e parë ishin oficerë policie, të cilët u trajnuan për komponentin social, menaxhimin e krizave e të tjera, në rastin konkret kemi persona me *background* ligjor ose social, të cilët trajnohen edhe për menaxhimin e ruajtjes së rendit dhe të së sigurisë publike. Pra, ata në një farë mënyre marrin një trajnim policor, nuk janë thjesht raportues, por janë persona, të cilët mund të parandalojnë një ngjarje që mund të ndodhë në vend.

Sa i takon pjesës...

Lorena Haxhiu – Po e marr fjalën për të plotësuar përgjigjen zoti Murrizi. Aktualisht kemi 83 oficerë sigurie, të cilët ushtrojnë detyrën e tyre pranë shkollave, 46 të tjerë, që kanë përfunduar trajnimin, pritet të emërohen në vijim deri sa të plotësohet numri 150 brenda vitit shkollor. Nga këta 83 që janë në detyrë, 60% e tyre janë femra. Gjinia nuk ka qenë kriter, pasi kriteret të veçanta, sikurse jua thashë ishin vetëm tre, por ja që ka ndodhur që 60% e tyre të jenë femra, ndoshta kjo nga shkalla e lartë e interesit për vetë profilin e këtij pozicioni pune nga ana e femrave.

Sa i takon përzgjedhjes së shkollave, ashtu sikurse ne e referuam që në hyrje, është vendosur si kriter numri i nxënësve dhe janë zgjedhur në rankim në rend zbritës shkollat me numrin më të madh të nxënësve, pra nuk ka qenë madhësia territoriale si një kriter i veçantë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Unë besoj se ka nevojë për një sqarim shtesë sa i takon kësaj pike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë Luan, do t’jua jap fjalën.

Ne shohim se ka gjimnaze, po marr si shembull gjimnazet në Tiranë, që e kalojnë shifrën e 1000 nxënësve, siç është gjimnazi “Ismail Qemali”, i cili ka 1720 nxënës, por ka edhe gjimnaze siç është ai i Bubqit në Krujë, i cili që ka 150 nxënës apo shkolla “Mustafa Atatürk”, në Kamëz, e cila numëron 151 nxënës.

Unë e kam të qartë që ju jeni nisur nga denduria për të përzgjedhur shkollat, por doja të dija nëse keni pasur parasysh raportin oficer-nxënës apo jo? Një oficer sigurie për 1700 nxënës dhe po aq për 150 nxënës, kjo është mënyra që keni operuar?

(Diskutime pa mikrofon)

Po prezantoj personin që do të na flasë për këtë çështje. Ai quhet Shkëlqim Allkaj, përgjegjës sektori pranë Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit. Sipas materialit që më është vënë në dispozicion ju keni qenë edhe pjesë e grupit rekrutues në Ministrinë e Arsimit për këtë çështje.

Fjalën e ka zoti Allkaj.

Shkëlqim Allkaj – Përshëndetje!

E nderuar zonja kryetare,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje Ministria e Arsimit me anë të një urdhri pune, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, ka organizuar një grup për koordinimin dhe realizimin e të gjitha detyrave deri në përfundim.

Për sa i takon pyetjes së zotit Murrizi, për përcaktimin e shkollave, si dhe të pyetjes suaj, zonja kryetare, si kriter kemi vendosur numrin e nxënësve, duke marrë si element renditjen e tyre nga shkollat me numrin më të madh të nxënësve deri te shkollat me numrin më të vogël të nxënësve. Është e drejtë ajo që thatë, që shkollat me numrin më të madh, si dhe ato me numrin më të vogël të nxënësve kanë një oficer sigurie, por qëllimi ynë ishte që ky projekt, ose ky vendim i Këshillit të Ministrave të shtrihej në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke u dhënë mundësi edhe shkollave dhe nxënësve në trevat më të largëta të vendit që ta kishin këtë shërbim në fazën e parë. Më pas nëse do të jetë e nevojshme, gjë që do të gjykohej nga institucionet, për ta shtuar numrin e oficerëve të sigurisë në të ardhmen dhe më pas këto shkolla ndoshta do të plotësohen me oficer të dytë sigurie.

Nga informacionet që kemi pasur deri tani kjo gjë ka funksionuar me pozitivitet dhe është pritur shumë mirë nga prindërit dhe nga nxënësit.

Ermonela Felaj – Kisha edhe një pyetje për ju, zoti Allkaj. Momenti do të vijë, pasi tani jemi në implementim e sipër dhe ndoshta është pak herët për t'i bërë të gjitha konkluzionet bashkë, por disa gjëra besoj se shihen dhe pranohen si konkluzione të natyrshme. A mendoni se duhej të shkojmë drejt përdorimit të të njëjtit raport ashtu siç e kemi me psikologët e shkollave?

Pra, kemi një psikolog për 700 nxënës në mos gabo, por ndoshta ky raport edhe mund të jetë ulur pas buxhetit të këtij viti ku u projektua edhe shtimi i numrit të psikologëve. A mendoni se duhet të shkojmë në këtë drejtim që të kemi po aq oficerë sigurie saç ka psikologë nëpër shkolla? Pra, në këtë mënyrë do të kemi një mbulim më të mirë për të gjithë pjesën e nxënësve dhe sigurisht secili prej tyre të bëjë punën e vet, sepse nuk mund të pretendojmë që punën e psikologut ta bëjë ai që nuk është psikolog, madje t'ju them të drejtën unë nuk do të isha shumë për marrjen e atyre që kanë mbaruar për psikologji, por të ishte përdorur kriteri i dikujt që ka mbaruar Akademinë e Rendit për këtë pjesë.

Unë nuk e di pse e keni përjashtuar këtë pjesë, por keni futur vetëm diplomat e drejtësisë dhe keni përjashtuar diplomat e atyre që kanë mbaruar Akademinë e Rendit. Kjo mund të ishte një pjesë me interes, sikundër edhe kriteri i moshës. Natyrisht unë do të isha për kriterin e poshtëm, që nuk të lejon të shkosh më tej, por jo për kriterin e sipërm. Sa i takon kriterit të sipërm do të gjykoja të ishte i hapur, sepse nuk më bën sens që dikush që ende nuk

ka krijuar familje të hyj kaq në thellësi të problemeve të fëmijëve, këtë e ndaj si prind, pasi në komision të gjithë jemi prindër, po ashtu edhe pjesa më e madhe juaj që jeni këtu besoj se jeni prindër, prandaj shpeshherë nga pozitat e prindit përballemi me fëmijët tanë dhe në disa raste nuk ndihemi mirë nga përgjigjet që ata marrin në shkolla nga ky nivel psikologësh dhe mësuesish.

Ne gjykojmë se e gjithë kjo vjen edhe për shkak të pjekurisë së këtyre njerëzve, të raporteve që ata arrijnë të krijojnë me fëmijët, të cilat sigurisht janë më të mira kur janë prindër, por ndoshta kanë mangësi në momentin që nuk e kanë këtë të dhënë. Unë mendoj se në një moment të dytë, duke marrë shkak edhe nga ato që do të diskutohen deri në fund në këtë komision, do të ishte mirë që ne të përmirësonin shumëçka në atë vendim dhe njëkohësisht të kemi mundësi t'i përmirësojmë kriteret me aq sa mundemi me qëllim që të përfitojmë njerëzit e duhur.

Ju thatë se na duhen edukatorë, jam shumë dakord me ju, sepse nuk presupozohet që oficer të jetë polici klasik ose figura e xhandarit që tremb fëmijët, por duhet të jetë patjetër një njeri që ka aftësi të krijojë besueshmëri në radhët e fëmijëve dhe për një problem, nuk jam duke thënë për probleme të tjera, por ato probleme që mund t'i godasin për faktin se ato mund të jenë krime, ose probleme ku tentohet që fëmijët të përfshihen në krim të kenë mundësi ku të drejtohen dhe ky të jetë njeriu i duhur dhe t'i japë rrugëzgjdhje problemit, për shkak edhe të *backgroundit* që ai ka, sepse pa dyshim *backgroundi* profesional është shumë i rëndësishëm në këtë pikë.

Zoti Rrushi e ka fjalën.

Edmond Rrushi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë jam shumë dakord që nëpër shkolla të ketë oficer sigurie, por doja të dija se cilat janë kompetencat që ka ky oficer sigurie?

Po lexoj pikën 3, të nenit 6, në të cilën thuhet: “Kryen patrullime përreth mjediseve të shkollave në rastet e situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorituzar në mjediset e shkollës apo të cenimit të pronës”. Ku është dallimi me rojen e shkollës? Me të vërtetë ky person është oficer sigurie, por këtë punë e ka bërë edhe roja i shkollës.

Në pikën 12 thuhet: “Në mënyrë periodike do të mbajë leksione të nxënësit për t'u dhënë bazat e aftësive të nevojshme për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm”. Ky oficeri i sigurisë do të japë bazat për t'i bërë nxënësit qytetarë të përgjegjshëm?

Pjesa tjetër flet për bashkëpunimin ku oficeri i sigurisë raporton për çdo shkelje të disiplinës apo të etikës pranë administratës së shkollës. Pra, detyra e oficerit të sigurisë është të konstatojë shkeljet dhe t'i referojë pranë drejtorisë së shkollës?

Po marr një rast, në qoftë se oficeri i sigurisë është pajisur me laptop. Po nëse në katin e katërt të një shkolle, disa nxënës përdorin lëndë narkotike, të cilët i filmon, cila është kompetenca e tij, sa i besueshëm është për ta referuar në polici ose në prokurori këtë rast?

Ermonela Felaj- Referencën e parë ato e kanë të përcaktuar që duhet ta bëjnë në Drejtorinë Arsimore, megjithatë kemi disa ndërhyrje.

Zonja Xhafaj, përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, një pikë që ne duhet ta përmendim është bashkëveprimi me njësitë e mbrojtjes së fëmijës që janë të ngritura në çdo bashki.

Fjala për ju.

Merita Xhafaj- Faleminderit!

Arsyeja që unë nuk fola në fillim lidhet me faktin që vendimi i Këshillit të Ministrave nuk e ngarkon Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale për zbatim, por për shkak të ligjit të mbrojtjes së të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës ne nuk jemi jashtë këtij bashkëpunimi. Do të doja të sqaroja një element shumë të rëndësishëm që mosha në të cilën quhen fëmijë është mosha deri në 18 vjeç, pra momenti që merr pasaportën. Në këtë moshë është bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Arsimit madje ministria jonë ka qenë pjesë e takimeve të komitetit drejtues lidhur me mënyrën e monitorimit të shkollave 9-vjeçare. Natyrisht, rastet e dhunës trajtohen jo vetëm nëpërmjet ligjit, por edhe të fëmijëve në konflikt me ligjin, sepse është bërë Kodi Penal për të Miturit. Legjislacioni i përmirësuar tre vjetët e fundit ka dhënë frymëmarrje për trajtimin e rasteve të dhunës ose të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Nga ana tjetër, është bërë një punë shumë bindëse në drejtim të parandalimit të këtyre rasteve dhe kjo në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, si dhe kujdestarët brenda klasave, sepse ka orë kujdestarie ku nxënësve u jepet informacioni i nevojshëm për parandalimin e dhunës.

Axhenda për fëmijët është, gjithashtu, një strategji kombëtare 3-vjeçare në këndvështrimin e së cilës ne kemi përgatitur raportin e fundit në bashkëpunim me institucionet, i cili do të miratohet edhe nga Këshilli Kombëtar i Fëmijëve, që drejtohet nga ministrja e Shëndetësisë dhe nga anëtarë jo vetëm në nivel ministrash, por edhe përfaqësues të ministrive

respektive, si edhe 5 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile. Në mbledhjen e ardhshme do të ketë përfaqësues nga fëmijët.

Do të mendoja që do të ishte shumë interesante nëse ju do të ftoni edhe fëmijët në këtë tryezë dëgjimi, sepse zëri i tyre dhe zgjidhja e problemeve të tyre realizohet në praninë e tyre. Ajo që është parë në rastet e dhunës është që fëmijët janë të ndrydhur, nuk shprehen.

Lidhur me aktet nënligjore dhe procedurën si referohet një rast, është vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili është miratuar në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, dhe që lidhet me menaxhimin e rastit. Pra, njësia e mbrojtjes së fëmijëve është direkt njësia përgjegjëse që merret me rastin, përgatit planin individual të fëmijës në risk dhe mënyrën e trajtimit të fëmijës në një kohë të caktuar. Ne kemi ngritur edhe qendrat emergjente të trajtimit të fëmijëve, që janë viktimat e dhunës seksuale, në të cilat trajtohen fëmijët në 24 orë, ku ofrohet shërbimi i mjekut ligjor, psikologut, të cilët janë *online*.

Do të doja të vija në dukje që është miratuar fondi në dispozicion, sepse një nga problematikat e rasteve të tilla është mënyra e financimit. Në momentin që ka një projekt, normalisht ndihmon projekti dhe financon projekti, por përtej këtij projekti është buxheti i shtetit ai që financon. Ngritja e mekanizmit të fondit social bën të mundur që nëpërmjet buxhetit të shtetit nëpërmjet fondeve të pushtetit vendor dhe donatorëve të mund t'i vihet në ndihmë realizimit të planit individual të trajtimit të rastit.

Ermonela Falaj- Zonja Xhafaj, kuptohet që problemi është shumë kompleks, por çdo komision ka tagrin e vet të të organizuarit të punës dhe ne ishim të interesuar në këtë aspekt. Ju ftuam për të kuptuar nëse ka bashkëveprim me njësitë e mbrojtjes së fëmijës, por figura që na intereson është ajo e oficerit të sigurisë, sepse kështu zbresim nga niveli teorik në atë praktik. Ka shumë institucione ose grupe që kanë për detyrë të bashkëpunojnë për të mirën e fëmijës, por ne duam të kuptojmë në nivelin praktik sa ka zbritur kjo punë, ose sa efektive është kjo punë, sepse nuk mund të mohohet që në shkolla ka pasur dhe vijon të ketë ngjarje që mbeten të rënda. Tema përbën interes, sepse flet për mundësitë që ne duhet t'u krijojmë në shkolla fëmijëve që të jenë të mbrojtur nga krimi, sikurse të mos jenë as subjekti që e kryen krimin, pra as subjekti pasiv, as subjekti aktiv.

Kjo ishte pjesa që ne kërkonim të dinim më shumë dhe pyetjet e kolegëve me këtë lidhen. Pra, a ka mundësi që edhe nëpërmjet këtij diskutimi t'u japim nxitje më të fortë punonjësve dhe institucioneve që e mbikëqyrin atë që edhe ato të kuptojnë si duhet bërë puna e tyre, me kë duhet të bashkëpunojnë dhe me kë duhet të jenë prezent?

Ju me të drejtë e ngritët sugjerimin që ne duhet të kishim dëgjuesë edhe me fëmijët. Mbase ne nuk e kemi menduar që të bëjmë një dëgjuesë të tillë, por ne kemi menduar diçka tjetër që të mund ta monitorojmë këtë çështje në disa nga gjimnazet kryesore të vendit për të kuptuar nëse është bërë sa duhet. Kështu që duhej të kishim një informacion nga ju ku është ecur, si është bërë përzgjedhja, ku janë vendosur sot këta njerëz dhe çfarë pritet deri në fillim të vjeshtës nga ky projekt.

Zoti Haliti.

Xhavit Haliti - Duke ju përgëzuar për nismën që keni marrë, sepse çdo shkollë meriton mbrojtje, doja t'ju pyesja zonja Kuko, me një muaj trajnim me agjencinë e sigurisë, a është i aftë ose a është personi i duhur që do t'i japë mbrojtjen e duhur fëmijëve?

Pse nuk bëhet e gjitha me oficerë të policisë?

Kam edhe një sugjerim, ngritja e një agjencie për këtë gjë, për oficerin e sigurisë që do të merret vetëm me këtë punë, t'i raportojë Ministrisë së Brendshme dhe asaj të Arsimit, të jetë një institucion më vete që të bëjë punën dhe pastaj të shikojmë si do të veprojmë.

Romina Kuko - Lidhur me periudhën kohore që do të duhej për t'i trajnuar këto individë për pjesën e rolit që ata do të marrin përsipër, ne mendojmë se është i mjaftueshëm një muaj trajnim intensiv dhe për rreth 5-6 orë në Akademinë e Sigurisë. Siç jua thashë profilet e tyre janë përzgjedhur të tilla që ata të jenë deri diku të plotësuar për rolin e tyre. E rëndësishme është që të marrin komponentin e zbatimit të ligjit, njohjen e ligjit dhe të zgjidhjes së konfliktit. Kjo mjafton që ata të marrin detyrën e tyre në momentin fillestar, sepse ne nuk kemi luksin që të trajnojmë 3 muaj në Akademinë e Sigurisë oficerë, të cilët janë të domosdoshëm për të zbatuar projektin. Sipas kriterëve të trajnimit të vazhdueshëm këta oficerë sigurie nëpër shkolla trajnohen në mënyrë të vazhdueshme, këtu kemi edhe përfaqësues nga prezenca e OSBE-së, të cilët mund të na thonë diçka për këtë, është një marrëveshje që ne kemi bërë për trajnimin e tyre të vazhdueshëm, lidhur me komponentë të tyre, kështu që këta oficerë sigurie marrin një trajnim bazë.

Pse jo oficerë policie? së pari, sepse nuk kemi një situatë alarmante emergjente që të vendosim oficerë policie në shkolla, nuk është rasti, nuk është e domosdoshme, sepse ai duhet të zbatojë ligjin, pra, nëse sheh një parregullsi në shkollë do të duhet të arrestojë, por neve nuk na intereson të fusim një klimë të tillë. Ajo çka ne kemi zbatuar në këtë projekt si koncept, dhe këtu i kthehem edhe komentit të kolegut tuaj, është paralajmërimi i hershëm, pra ne kemi dashur të krijojmë një fashë sigurie në shkolla për paralajmërimin e hershëm. A është e mundur që të paralajmërojmë konfliktet para se ato të majisen dhe të shkojnë deri në përplasje fizike?

Për këtë arsye kemi zgjedhur një rol neutral që është ai kanadez i oficerit të sigurisë, i cili parandalon, paralajmëron dhe nuk vepron për të zbatuar ligjin, sepse atëherë është shumë vonë.

Lidhur me pjesën e agjencisë ka disa forma raportimi, aktualisht janë drejtoritë arsimore, të cilat mbledhin këtë informacion, është IZHA. Kështu që nuk është e domosdoshme të kemi agjenci të posaçme, deri tani ka funksionuar dhe nuk është e nevojshme të ngrihet një institucion më vete.

Sadri Vorpsi – Faleminderit!

Unë dëgjova me vëmendje raportet e të dy institucioneve, të cilët i vlerësoj, sepse është një projekt goxha ambicioz që ka dhënë rezultate të prekshme.

Nuk dua të ndalem shumë në probleme teknike, sepse i prekëm. Ne kemi qenë në një takim informues në drejtoritë policisë ku vëmendja e strukturave ose institucioneve ligjzbatuese për sigurinë në institucionet e arsimit ka qenë e madhe dhe efektive. Unë do të doja të pyesja për një bashkëpunim me pushtetin vendor sa ka qenë ky lloj koordinimi, sepse është institucioni, i cili mbulon infrastrukturën me ligjin e ri të reformës administrative territoriale?

Kjo ishte pyetje ime për ju.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Vorpsi!

Besoj se pyetja juaj është me vend dhe personi që duhet të përgjigjet është Ministria e Brendshme, sepse pyetja lidhej me një aspekt të një ligji tjetër, që ju e keni përgjegjësinë ta zbatoni, që është ligji “Për masat shtesë të sigurisë publike”. Ka bashki që janë aktivizuar në këtë proces duke siguruar pajisjen me kamera të gjimnazeve, sikundër ka edhe të tjera që nuk kanë bërë pjesë të buxhetit të tyre parashikimin dhe planifikimin financiar për të vendosur kamera. Normalisht duhet të ketë një shtrëngim në këtë pjesë që të gjitha gjimnazet në vend të jenë të pajisur me sisteme kamerash, sepse kjo lehtëson punën e të gjithëve.

Romina Kuko - Faleminderit, zonja kryetare!

Zoti Vorpsi, faleminderit për komentin tuaj!

Për konstatimin e pajisjeve me kamera të gjimnazeve, si zbatim i ligjit për masat shtesë të sigurisë dhe udhëzimit që është miratuar pas tij, gjithashtu edhe ndërlidhjen që ka ky projekt me pushtetin vendor, si ministria që koordinon pjesën e pushtetit vendor dhe si zëvendësministri përgjegjës për pjesën e këtij koordinimi, dua t’ju them se ne kemi ndërmarrë një hap për nxitjen e ngritjes së këshillave vendorë për sigurinë publike, të cilët janë organizma ndërsektorialë brenda bashkisë. Pra, kemi nxitur ngritjen e këtyre këshillave, të cilët bashkojnë kryetarin e bashkisë, drejtorin e policisë dhe të gjitha elementet vendore, si: shërbimin

shëndetësor, Drejtorinë Arsimore e të tjera, ku diskutohen sfidat e sigurisë në këto bashki. Shumë shpejt do t'i kemi këta këshilla rajonalë edhe pranë prefektit të qarkut, të cilat do të monitorojnë pjesën e bashkive, por ne do të donim t'i kishim të mirëpërcaktuara me një rregullore, e cila më pas ka edhe pjesën e raportimit.

Aktualisht, kemi njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë bashkive, të cilat në pjesën dërrmuese të bashkive funksionojnë dhe bashkëveprojnë me oficerët e policisë, përgjegjës për dhunën në familje dhe mbrojtjen e të miturve. Duhet thënë që nuk ka pasur problematika, por ka nevojë për një koordinim shumë më të ngushtë për sa i përket këtij elementi.

Përfitoj nga rasti, gjithashtu t'ju kërkoj ju, si Komision Sigurie, që, kur të shkoni të kryeni vizitat tuaja nëpër bashki, të nxisni funksionimin e këshillave vendorë për sigurinë publike, sepse janë organizma eficientë si për raportim, si për pjesën parandaluese.

Faleminderit!

Megi Llubani – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke qenë se u përmend disa herë emri i OSBE-së, do të doja të bëja një koment të shkurtër lidhur me mbështetjen që kemi dhënë. Ne kemi qenë të pranishëm që prej pilotimit të këtij projekti dhe kemi bërë një vlerësim jo vetëm të pozicionit të punës, të përgjegjësisë që do të kenë oficerët e sigurisë, por edhe funksionimin e tij në fazën e pilotimit.

Mbështetja jonë nuk do të përfundojë aty, përgjatë këtij viti dhe në vitet në vazhdim OSBE-ja është e angazhuar dhe po ofron mbështetje për forcimin e rolit të tyre. Ne kemi parashikuar këtë vit trajnime të mëtejshme të oficerëve të sigurisë, sidomos me komunitetin dhe të rinjtë.

OSBE-ja ka dhënë një mbështetje të madhe për krijimin e këshillave të sigurisë publike dhe po vazhdon me mbështetjen për krijimin e planeve të veprimit të këtyre këshillave. Për këtë vit, në tri prej tyre, ku do të punojmë, kemi planifikuar që oficerët e sigurisë të jenë pjesë e trajnimit që do të kemi me këshillat e sigurisë publike dhe me takimet që kemi parashikuar me të rinjtë për adresimin e çështjeve të sigurisë, përfshirë këtu radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Dua të përmend që jemi vërtet shumë të kënaqur me mënyrën se si ka shkuar procesi, pasi është bërë në një kohë shumë të shkurtër dhe në mënyrë efikase dhe është përhapur pothuaj në të gjithë Shqipërinë.

Ne jemi të gatshëm dhe do të vijojmë mbështetjen tonë me institucionet tona partnere.
Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, për ndërhyrjen tuaj!

Na vjen mirë që jeni në brendi të gjësë, sepse edhe Komisioni i Sigurisë Kombëtare ka një marrëveshje dyvjeçare bashkëpunimi me OSBE-në, kështu që është momenti të kuptojmë se duhet të jemi pjesë e ndërsjelltë bashkëpunimi edhe me institucionet qendrore për të përmirësuar gjithë instrumentin ligjor që jo domosdoshmërisht është vetëm ligji, por edhe vendimet e Këshillit të Ministrave.

Kujtoj që bëja detyrën si ministre e Shtetit e Marrëdhënieve me Parlamentin, dhe fatmirësisht ajo figurë është kthyer tashmë në qeveri dhe një nga detyrat ishte që vendimet e Këshillit të Ministrave, pavarësisht se merren nga Këshilli i Ministrave, të mund të konsultoheshin për atë sa ato impaktojnë edhe me komisionet përkatëse parlamentare. Kjo vlen në vijimësi, që vendime të kësaj natyre, e mira është që para se të miratohen nëpërmjet ministrit të Shtetit të Marrëdhënieve me Parlamentin, të mund të konsultohen edhe me komisionet që kanë përgjegjësi në këtë fushë, me qëllim që të bëjmë vendime sa më të mira dhe të mos detyrohemi t'u rikthehemi për t'i plotësuar apo për t'i përmirësuar.

Bashkëpunimi ndihmon gjithmonë në ngritjen e cilësisë. E them këtë për ta vënë në vëmendjen e zëvendësministre të thirrura sot, por edhe të ministrave në përgjithësi, që ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin këtë detyrë ka: të lehtësojë sa më shumë të jetë e mundur marrëdhënien mes ekzekutivit dhe legjislativit, me qëllim që vendimet që merren, qofshin ligje apo VKM, të jenë të natyrës së tillë që të shkaktojnë sa më pak debat, ose thënë ndryshe, të jenë të gjithëpranuara.

Kështu që bëjeni dhe këtë pjesë, se gjithmonë vlen!

Zoti Duzha kishte një pyetje. Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpreva pak më herët!

Më pas, fjalën do t'ia jap edhe një herë zotit Zeneli, për ta konkluduar këtë seancë dëgjimore.

Luan Duzha – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit edhe ju, për të gjithë paraqitjen që bëtë!

Pyetja ime është: a do të vazhdojë ky projekt në të gjitha gjimnazet që ka vendi, apo do të ngelet në këto 150 shkolla?

Së dyti, nga varen këta oficerë sigurie? Nëse këta nuk kryejnë detyrën, si shkarkohen?
Faleminderit!

Ermonela Felaj - Pyetje me interes, zoti Duzha.

Besoj që edhe trajtimi financiar i tyre do të ishte një informacion që do të na vlente.

Shkëlqim Allkaj – Oficerët e Sigurisë janë të përcaktuar brenda numrit të miratuar të punonjësve dhe paguhen si strukturë nga drejtoritë arsimore, por, siç e thamë në të gjithë këtë

ligjëratë, janë një strukturë e dyfishtë që ka varësi nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Brendshme, që buron nga marrëveshja e nënshkruar nga këto dy ministri.

Një detaj i rëndësishëm që duhet thënë është se për konfirmimin e tyre në detyrë, në fund të periudhës së provës, do të shprehet drejtori i institucionit arsimor ku ky oficer ushtron detyrën e tij dhe inspektori i policisë së zonës në të cilën ndodhet shkolla, mbi bazën e një formulari dhe disa kriterëve standarde të përcaktuara nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit, që do t'u shkojnë së shpejti drejtorive të policisë dhe drejtorive arsimore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ata kanë filluar punë me kontratë pune pa afat, ku sipas Kodit të Punës, 3 muajt e parë janë periudhë prove dhe në fund të periudhës së provës duhet të shprehen dy struktura, drejtori i shkollës dhe inspektori i policisë së zonës, të cilët do të japin konfirmimin nëse ky punonjës e meriton të vazhdojë më tej detyrën e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Barazohet me pagën e psikologut dhe të punonjësit social. Janë në të njëjtën VKM nr. 175, të ndryshuar së fundi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ata nuk konfirmohen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të veprohet në përputhje me Kodin e Punës, me të gjitha dispozitat që parashikon drejtori i shkollës.

Si strukturë, kontratën e punës e ka nënshkruar me drejtorin aktual të zyrës arsimore, por ai është një strukturë brenda shkollës dhe listëpagesat dhe të gjitha procedurat e tjera kryhen brenda shkollës. Do të jetë një bashkëpunim midis drejtorit të shkollës dhe drejtorit të arsimit në rastet kur puna e tij çalon apo nuk kryhet sipas standardeve të kërkuara.

Ermonela Felaj -Faleminderit, zoti Allkaj!

(Diskutim pa mikrofon)

Lorena Haxhija - Objektivi është që ne të pajisim 150 shkolla, të cilat tashmë janë të targetuara brenda vitit shkollor 2018-2019 me 150 oficerët e sigurisë. Sigurisht që duke monitoruar ecurinë e projektit, do të vlerësohet edhe shtrirja më e gjerë ose jo, vitet e ardhshme.

Objektivi është që shtrirja të vijojë për sa kohë që në fazën pilot ne kemi marrë rezultatet e para, sepse 80 raste të parandalimit të dhunës në shkolla në 10 javë është vërtet shumë, sepse edhe numri i gjimnazeve ka qenë i ngushtë vetëm 15 gjimnaze të vendosura në territorin e qytetit të Tiranës.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Haxhija!

Fjala për zotin Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë, dua të falënderoj të gjithë të ftuarit!

Siguria, në përgjithësi, por sidomos siguria e fëmijëve është gjëja më e rëndësishme në mbarëvajtjen e gjithë jetës sonë, edhe ne si ligjvënës e vlerësojmë atë projekt. Ky komision e mbështet këtë lloj projekti dhe gjithçka që ka të bëjë me sigurinë e fëmijëve.

Do të doja të bëja një pyetje më shumë specifike: (ndoshta është pak herët, por ju e cekët në fjalën e fundit) matësi i kësaj pune, në fund të fundit, është rezultati. A keni ju një statistikë të mirëfilltë të punës së **83**, siç e cilësuat ju, ndryshe nga çfarë ka ndodhur më parë në këto shkolla? Cili është ndryshimi mes punës së mëparshme në shkolla me vendosjen e oficerëve të sigurisë te këto **33** shkolla? Keni ndonjë statistikë të saktë për këtë?

Ermonela Felaj – Ju përmendët një shifër, 30 raste që mendoni se janë parandaluar, që i bie një për çdo punonjës.

Romina Kuko – Lidhur me matjen e performancës dhe me statistikën para dhe pas, për të parë ndryshimin, ne kemi zhvilluar një pyetësor në gjimnazet e Tiranës, përpara se ky projekt të zbatohet nga projekti “Policimi në komunitet” me mbështetjen e qeverisë suedeze. Ne kemi një raport të perceptimit të sigurisë në ato shkolla dhe do të bëjmë një ripërsëritje të këtij pyetësori, gjithashtu edhe tani pasi projekti është zbatuar. Domethënë, kjo është njësia matëse me të cilën ne mund të matim perceptimet e sigurisë së nxënësve në këto shkolla.

Nuk kemi ende mekanizma për të pasur indikatorë të qartë të matjes së sigurisë, sepse kur flasim për parandalimin e rasteve, rastet kanë kompleksitetin e tyre duke filluar nga bulizmi, shenjat e para deri te konfliktet, kapjen e armëve të ftohta e të tjera, dhe kjo ngelet për t’u parë në vijim në qoftë se mund të zhvillojmë një instrument për matjen e performancës së tyre me indikatorë të qartë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Në fakt, ky duhet të ishte konkluzioni. Ne duhet të bëjmë të mundur që këta persona që po i vendosim në 150 shkolla të mesme në të gjithë Shqipërinë të mund të jenë sa më vizibël, sa më të njohur për nxënësit, mësuesit dhe komunitetin. Ne duhet t’u krijojmë kushte sa më të mira pune dhe është me vend ideja që trajnimi i tyre të mos jetë vetëm një herë, por të jetë në mënyrë të vijuar. Nga ana tjetër, duhet të gjejmë formulën që i bën këta njerëz të jenë shumë më të përgjegjshëm për detyrën që kanë marrë përsipër, sepse, vetëm në fund të ditës mund të jemi të bindur që fëmijët tanë janë të siguruar maksimalisht nëpër shkolla.

Shpresoj që kjo mbledhje të ketë ndikuar sadopak për të rritur interesin dhe vëzhgimin në këtë pikë, me qëllim që të krijojmë mundësinë e zbatimit sa më efektiv, që, në fakt, duhet thënë që ka qenë i menduar mirë dhe kishte ardhur momenti që kjo gjë të ndodhte në shkollat tona.

Faleminderit për vëmendjen!

MBYLLET MBLEDHJA